

KËRKESE
Nr. 730/9, datë 15.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 117, datë 26.2.2025, të Këshillit të Ministrave, ‘Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës’””.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Shkodër.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 69,713,289 lekë (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur, dhe me efekt financiar shtesë mbi VKM-në në bazë, 3,582,819 lekë (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë), sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Shkodër si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit në lidhje me projektin e sipërcituar është 69,713,289 lekë (gjashtëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë dhe me efekt financiar shtesë 3,582,819 (tre milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

[illegible]